



Pranuar / Dorezuar Puniljeno / Prodato Received / Delivered	07-03-2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypje Printog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHIK	1220/2022		114



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.85/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malësore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.85/2022 të datës 02.02.2022 të parashtruar nga ankuesja Xhemile Zhushi, të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat [redacted] në Komunën e Podujevës, kundër Vendimit me 01Nr. 48-182/2021 të datës 05.07.2021 të Inspektoratit të Punës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 07.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.85/2022 e datës 02.02.2022 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesja sipas shkresave të lëndës ka qenë e punësuar në Komunën e Podujevës sipas Akt Emërimit të datës 05.01.2015 në pozitën "Zyrtare për Projekte". Menaxheri i Personelit më datë 06.04.2021 ka nxjerr Vendim me Nr.13-118/02-0030452/21 për përfundimin e marrëdhënies së punës së ankueses për shkak të arritjes së moshës së pensionimit nga data 10.04.2021, ndërsa Kryetari i Komunës së Podujevës më datë 05.05.2021 ka nxjerr Vendim me Nr. 02-400/01-0036223/21 me të cilin i lejohej kompensimi i një page mujore të njehershme në vlerën e pagës së fundit 522.87 Euro për ankuesen në emër të pensionimit.

Ankuesja gjegjësisht përfaqësuesi i autorizuar duke mos pasur njohuri lidhur me kompetencën lëndore ka parashtruar ankesë në Inspektoratin e Punës, ndërsa Inspektorati i Punës ka marr vendim me Nr.48-182/2021 të datës 05.07.2021 të Inspektoratit të Punës më të cilin kanë shpallur vetën jo kompetent lidhur me vendosjen e ankesës, sepse ankuesja ka pasur status të nëpunëses civile në Komunën e Podujevës. Ankuesja përmes përfaqësuesit të saj me postë më datë 31.01.2022 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar më datë 02.02.2022 dhe është regjistruar me numër të ankesës A.nr.85/2022 me Nr. Prot:491/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.02.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses në Komunën e Podujevës. Më datë 23.02.2022 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Podujevës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. Prot:491/2022 të datës 02.02.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt Emërimit të datës 05.01.2015; Vendim i Inspektoratit të Punës me numër 01Nr.48-182/2021 i datës 05.07.2021; Autorizimin për përfaqësim i datës 09.06.2021; Letërnjoftimin e ankueses; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 11.02.2022; Përgjigje në ankesë e datës 23.02.2022; Vendim për përfundimin e marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil me numër Nr.13/118/02-0030452/21 i datës 06.04.2021; Vendim për pagesë për pensionim me numër Nr.02-400/01-0036223/21 i datës 05.05.2021; Urdhër pagesë përmes Ministrisë së Financave-Thesarit për pagesën e vlerës 522.87 Euro e datës 09.06.2021; Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 19.04.2021; Vërtetim nga Njësia e Burimeve Njerëzore me numër Nr.13-113/01-0032102/21 i datës 12.04.2021; Lista e pagave Dhjetor 2013; Libreza e punës e me numër 141753; E-mail nga F.B. për C.Z. i datës 28.02.2022; Pliko me numër R2167931 i datës 21.02.2022;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e palejuar, sepse:**

Në bazë të Vendimit me Nr. 13-118/02-0030452/21 i datës 06.04.2021 për përfundimin e marrëdhënies së punës së ankueses dhe Vendimit me Nr. 02-400/01-0036223/21 të datës 05.05.2021 të Kryetarit të Komunës së Podujevës, pala e pakënaqur kundër këtyre vendimeve ka pasur të drejtë të ankohet në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës brenda 30 ditësh, mirëpo Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se bazuar në provat e lëndës nuk ka dëshmi që kur ankuesi e ka pranuar Vendimin me Nr. 13-118/02-0030452/21 i datës 06.04.2021 për përfundimin e marrëdhënies së punës së

ankueses, mirëpo në provat e lëndës si dëshmi është Urdhër Pagesa e datës 09.06.2021 me të cilën dëshmohet se ankueses i është bërë kompensimi i një page të njëhershme në vlerën 522.87 Euro, po ashtu ankuesja përfaqësuesin e tij për përfaqësim në gjykata dhe institucionet të tjera sipas autorizimit e ka autorizuar të përfaqësoj më datë 09.06.2021.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se ankuesja ka qenë në dijeni me kohë për aktet juridike të nxjerra nga Komuna e Podujevës e që kanë të bëjnë me përfundimin e marrëdhënies së punës respektivisht me kompensimin e mjeteve në llogarinë e tij bankare sipas Vendimit me Nr. 02-400/01-0036223/21 të datës 05.05.2021 të Kryetarit të Komunës së Podujevës, si rrjedhojë kjo përbën fakt juridik që ankuesja me rastin e pranimit të kompensimit ka qenë e njoftuar për këto veprime.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në këshillën juridike të Vendimit me Nr. 13-118/02-0030452/21 i datës 06.04.2021 për përfundimin e marrëdhënies së punës së ankueses dhe Vendimit me Nr. 02-400/01-0036223/21 të datës 05.05.2021 të Kryetarit të Komunës së Podujevës, si dhe faktin që në muajin qershor 2021 i është bërë kompensimi i një page të njëhershme me rastin e pensionimit, këto vendime kanë prodhuar efektet juridike sipas nenit 51 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Një akt administrativ fillon të prodhojë pasojat juridike në raport me palën të cilës i drejtohet apo e cila cenohet nga ai, me njoftimin e përmbajtjes të tij"*, si rrjedhojë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se ankesa e ankueses e parashtruar përmes postës më datë 31.01.2022 përmes përfaqësuesit të saj në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është në kundërshtim me dispozitat e nenit 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet se: *"Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative")"*, dhe nenit 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *"Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"*, andaj ankesa e ankueses e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është e papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet se: *"Ankesa është e pranueshme nëse i plotëson këto kushte: 1.3. ajo është parashtruar brenda afatit të parashikuar nga neni 127 i këtij ligji"*, në këtë rast ankesa e ankueses është e parashtruar jashtë afatit ligjor sipas dispozitave të lartcekura.


Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.85/2022

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Esref SHABANI


Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankueses [redacted]
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

